



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:002948

Datë: 14.12.2020

Numri i dokumentit: 01341232

**PKR.nr.104/20**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Departamenti për Krime të Rënda**, sipas Kryetarit të Trupit Gjykes Sami Sharaxhiu, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Lulavere Mala, në lëndën penale ndaj të akuzuarit E. K. nga fsh.....K-....., për shkak të veprës penale, mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366 par.1. të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së PTHDP ne Peje PP/II.nr.20/2020, të datës 15.01.2020 dhe Marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë me numër dhe datë të njëjtë, e përfaqësuar nga PTHDKR në Pejë, në seancën publike të shqyrtimit të marrëveshjes së pranimit të fajësisë, të mbajtur me datë 09.12.2020, në praninë e Prokurorit të Shtetit Valbona Disha Haxhosaj , të akuzuarit E. K. dhe mbrojtësit të tij sipas detyrës zyrtare av.Adem Nikqi , me datë 09.12.2020\_murr dhe publikisht shpalli , ndërsa me datën 14.12.2020 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari**

**E. K.** , i lindur me datë ..... , në fsh. ...., K- ...., ku edhe jeton , i biri i S. dhe nënës N. e gjinisë M., ka të kryer shkollën fillore, punëtor me profesion , e gjendjes së mesme ekonomike, e njohur sipas numrit personal ..... MPB e Kosovës , Shqiptar , shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në liri.

**ËSHTË FAJTOR**

**Për shkak se:**

Me datë 26.12.2019 , rreth orës 20:30 , ne fsh.....K-.... , i pandehuri ne kundërshtim me nenin 5 par.1 te Ligjit për Arme (Ligji nr. 05/L-022) , ka mbajtur ne pronësi dhe kontroll te paautorizuar dhe at një pistolete te llojit .., prodhim i panjohur dhe cal.7.65mm si dhe dy (2) fishekë te te njëjtit kalibër ne atë mënyrë qe i njëjti qe nga pas lufta gjer me datën e lartcekur ka mbajtur ne posedim armen ne fjale , me ç’rast ditën kritike te njëjtat i janë gjetur dhe sekuestruar djalit te tij te mitur M.K

- me çka ka kryer vepër penale mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform nenit 2, 4 par.1. nënpar.1.1. dhe 1.3 nenit 7, 8, 38 par.1, 39 par.1. nënpar.1.1 dhe 1.3, nenit 40, par.1. nënpar.1.3, nenit 43, neni 366 par.1 dhe neni 366 par.3 të KPRK-së, si dhe nenit 233 të KPPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

## **DENIM ME GJOBË**

Ashtu që të akuzuarit së lartcekur i caktohet dënimi me gjobë në shumë prej **500** €, ( pesëqind euro ) të cilin dënim obligohet që ta paguaj ne afat prej (gjashtë) e 6 muaj , pas plotfuqishmërisë se aktgjykimit.

Nëse i akuzuarit nuk e paguan dënimin me gjobë të cekur si më lartë brenda afatit të caktuar, atëherë dënimi me gjobë do ti zëvendësohet me dënim me burg ku një ditë burg do ti llogaritet në shumë prej 20 € ( njëzet euro) .

I akuzuari obligohet që në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t'ia paguaj shumën prej 20 €, (njëzet euro) dhe shumen prej 50 ( pesëdhjetë euro) në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Ndaj te pandehurit në kuptim të nenit 366 par.3 të KPRK-së, shqiptohet

## **DËNIMI PLOTËSUES – MARRJA E SENDEVE/KONFISKIMI**

- një pistolete te llojit ..., prodhim i panjohur me cal.7.65 mm si dhe
- dy (2) fishekë te te njëjtit kalibër.

E të gjitha këto sende të konfiskuara si më lartë, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit urdhërohen që të shkartoehen.

## **A r s y e t i m**

PTHDP në Pejë, ka ngrit Aktakuzën PP/II.nr.20/2020, të datës 15.01.2020, kundër të akuzuarit E. K. , nga fsh. ...., K-...., për shkak të veprës penale ,mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve ,nga neni 366 par.1të KPRK-së, aktakuzë të cilën tani e përfaqëson PTHDKR në Pejë, dhe së bashku me aktakuzë ka arritur edhe marrëveshja për pranimin e fajësisë me numër dhe datë të njëjtë.

Sipas Njoftimi AGJ.nr.156/2020, të Gjykatës së Apelit, pas mbledhjes së mbajtur nga ana e gjyqtarëve të departamentit penal, është vendosur që vepra penale mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366, është në kompetencë të Departamentit për Krime të Rënda dhe si e tillë duhet të gjykohet në këtë departament.

Gjykata mbajti seancën e shqyrtimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë me datë 09.12.2020, në praninë e prokurorit të shtetit, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij.

Gjatë seancës u shqyrtua marrëveshja mbi pranimin e fajësisë ku sipas marrëveshjes, i pandehuri është pajtuar që për veprën penale ,mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366 par.1të KPRK-së, t'i shqiptohet dënimi me gjobë në shumë prej 500 - 600 € . Po ashtu i akuzuari është pajtuar që të heq dorë nga e drejta e tij për

gjykim dhe gjithë të drejtat e tjera të përshkruara në deklaratën bashkëngjitur marrëveshjes, të cilën e konfirmuan edhe gjatë seancës.

Gjatë kësaj seance gjykata është bindur se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare pas konsultimeve me mbrojtësin e tij dhe se i akuzuari nuk ka qenë i detyruar apo i shtrënguar në asnjë mënyrë të pranoj fajin. Pranimi i fajësisë mbështetet në provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe se nuk ekziston asnjë rrethanë për hedhjen e aktakuzës që parashihet me nenin 253 par.1 dhe 2 të KPPRK-së.

Pas bindjes së gjykatës për të lartcekurat, dëgjimit të pikëpamjeve të prokurorit dhe të mbrojtësit të akuzuarit lidhur me rastin e shqyrtimit të marrëveshjes së pranimit të fajësisë, gjykata konstatoj se i akuzuari e ka pranuar fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, i akuzuari është i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 248 par.1 të KPPRK-së janë përmbushur. Ashtu që gjykata aprovon marrëveshjen për pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 248 par. 1 të KPPRK-së, janë përmbushur, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas aprovimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, në kuptim të nenit 248 par. 4 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara në shkresat e lëndës e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të akuzuarit Enver Kelemendi qëndrojnë elementet e veprës penale ,mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i akuzuari ka kryer veprën me dashje, ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarit, kështu që i njëjta është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të akuzuarin gjykata ka vlerësuar faktin se i njëjti më parë kishte pasur sjellje korrekte, sjelljen e tij korrekte gjatë seancës së shqyrtimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, si dhe pendimin e thellë të tij, duke i premtuar gjykatës se në të ardhmen një gjë të tillë më nuk do ta përsëris. Si rrethanë tjetër lehtësuese, gjykata murr për bazë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë e lidhur në mes të akuzuarit dhe prokurorit të shtetit ku i akuzuari ka pranuar fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë dhe kjo sipas vlerësimit të Gjykatës paraqet pendim të sinqertë dhe fillim të procesit të rehabilitimit të tij. Ndërsa, rrethana rënduese gjykata nuk gjeti.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, gjykata në kuptim të nenit 69 të KPRK-së të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, me të cilin do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e

qëllimit të dënimit në pengimin e të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por ai do të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 38 të KPPRK-se.

Duke u bazuar ne nenin 450 të KPPRK-së, gjykata për të akuzuarit i ka përcaktuar shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumë prej 20 (Njëzet euro) euro dhe shumë prej 50( pesëdhjetë euro) në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit

Ndaj të pandehurit në kuptim të nenit 366 par.3 të KPRK-së të KPRK-së, është shqiptuar edhe dënimi plotësues i marrjes së sendit, respektivisht konfiskimi i armës dhe municionit të përshkruar sikurse në dispozitiv të aktakuzës, dhe të njëjtat është urdhëruar që të konfiskohen.

Nga të cekurat si më lartë, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**  
**P.nr.104/20, më datë 14.12.2020**

**Sekretarja Juridike**  
*Lulavere Mala*

**Kryetari i Trupit Gjyqësor**  
*Sami Sharaxhiu*

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.